

VENDIM
Nr.21, datë 1.11.2007

**PËR SKEMËN EKZISTUESE TË PAGESËS SË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË
NDËRMARRJEVE ME KAPITAL SHTETËROR**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z.Genc Ruli	- kryetar
Znj.Mimoza Dhëmbi	- anëtare
Z.Viktor Gumi	- anëtar
Z.Ledi Bianku	- anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 1.11.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese të pagesës së detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve me kapital shtetëror”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AL/014/2005.

BAZA LIGJORE: Si bazë për dhënien e fondeve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ka qenë ligji nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, ligji nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.711, datë 18.10.2006 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njërive të qeverisjes vendore”.

OBJEKTIVI/AT: Skema synon të përmirësojë dhe të shëndoshë situatën financiare të ndërmarrjeve me kapital shtetëror, duke normalizuar llogaritë e tyre, nëpërmjet mekanizmit të pagesës së detyrimeve të prapambetura dhe të ndërsjella.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë të dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema mbulon kryesisht sektorin e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve, duke synuar zvogëlimin e shumës së detyrimeve të prapambetura të kontabilizuara në pasqyrat e gjendjes pasurore për secilën ndërmarrje.

2. Masa klasifikohet si një ndihmë operacionale që jepet për të lehtësuar veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve përfituese, nëpërmjet reduktimit të një pjese të shumës së detyrimeve të akumuluar. Megjithatë, mbështetja mund të justifikohet për shkak të natyrës së saj, pasi furnizimi me ujë të pijshëm konsiderohet një shërbim me interes publik.

3. Ndërmarrjet e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve kanë akumuluar në vite shuma të mëdha detyrimesh ndaj KESH sh.a.-së. Shkak për këtë situatë ka qenë menaxhimi i dobët i veprimtarisë së tyre ekonomike në drejtim të humbjeve teknike në rrjet si pasojë e rrjetit të amortizuar, faturimit të prodhimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga faturimet, si dhe detyrimi për ofrimin e shërbimit publik, duke mos orientuar çmimet drejt kostos.

4. Skema ka filluar të zbatohet që nga viti 2002 dhe fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për këtë qëllim kanë qenë në rënie nga viti në vit.

5. Për vitet 2005 dhe 2006, intensiteti i ndihmës në kuadër të skemës së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve llogaritet në 24,8 %. Duke e akumuluar vlerën e ndihmës për këto ndërmarrje edhe me përfitimet që kanë marrë edhe nga skema e subvencionimit të drejtpërdrejtë, intensiteti arrin në masën 39,6 %.

6. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007 aksionet e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve u transferohen njërive të qeverisjes vendore dhe detyrimet e prapambetura të tyre, deri në çastin e transferimit, do të shlyhen nga Buxheti i Shtetit, duke zhveshur bilancet e shoqërive nga ato detyrime përpara se të kryhet transferimi i aksioneve.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13, shkronja “c”, nenin 15, pikat 2 dhe

3, nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, në nenin 7 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005, si dhe në nenet 19 dhe 21 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Të konsiderojë skemën në përputhje me kriteret e legjislacionit të ndihmës shtetërore.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve të raportojë pranë DNSH-së për ecurinë e zbatimit të skemës deri në afatin e transferimit të ndërmarrjes së fundit drejt pushtetit vendor.
3. Ministria e Punëve të Brendshme të raportojë, brenda datës 31 mars të vitit 2008, pranë DNSH-së për vlerën totale të ndihmës së dhënë ndërmarrjeve të ujësjetllësve, në kuadër të skemës, gjatë vitit 2007.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli